

## **MBI AUDITIMIN E PERFORMANCËS TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, - TIRANË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës të ushtruar në **Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë**, me objekt: “*Ecuria e artikujve që trajtohen me akcizë në import dhe në prodhimin vendas, influenca e tyre në të ardhurat e buxhetit të shtetit*” dhe rekomandimet për masat që duhen marrë, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 152, datë 11/10/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 120/15, datë 11.10.2012, **dërguar Z. Flamur Gjymishka, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka dërguar përsa më poshtë vijon:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Ministria e Financave të marrë masa për përgatitjen dhe dërgimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të programit të ardhurave që duhen realizuar nga akciza, të detajuar në strukturë dhe në zëra për artikujt e importit dhe të prodhimit vendas.

#### **Vazhdimisht**

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të rrisë përgjegjësinë dhe të forcojë punën e strukturave të specializuara dhe degëve doganore të saj në drejtim të investigimit, monitorimit dhe kontrollit të subjekteve importues dhe prodhues të artikujve të akcizës. me qëllim minimizimin e fenomeneve që ndikojnë negativisht në realizimin e të ardhurave nga akciza në Buxhetin e Shtetit.

#### **Vazhdimisht**

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të ndërmarrë studimin dhe t’i propozojë Qeverisë zgjidhjet ligjore për mundësinë e vënies në eficiencë të industrisë përpunuese të naftës në vend duke hartuar dhe një Plan Strategjik Afatgjatë për këtë qëllim.

#### **Menjëherë**

4. Për të rritur prodhimin, punësimin e për rrjedhojë të ardhurat nga akciza, Ministria e Bujqësisë të realizojë objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik të miratuar nga Qeveria, që deri në fund të vitit 2015 të arrihet mbjellja në zonat rurale të cilat kanë kushte të përshtatshme klimatiko - tokësore, 20 mijë hektar vreshta dhe një sipërfaqe deri në 10 mijë hektar me duhan

#### **Menjëherë**

5. Ministria e Financave në bashkëpunim me Institucionet e tjera, të studiojë mundësinë e përafrimit të gamës së artikujve që trajtohen me akcizë me direktivat e BE-së si dhe ndryshimet ligjore për nivelin e akcizës që dërgohen për miratim në Parlament të kenë efekt për periudha sa më të gjata kohore.

#### **Menjëherë**

6. Si një faktor për uljen e evazionit në të ardhurat nga akciza, të institucionalizohet dhe të forcohet niveli i bashkëpunimit ndërmjet DPD dhe institucioneve të tjera shtetërore që ndjekin politikën, nxitjen dhe evidentimin e prodhimit të artikujve të akcizës kryesisht për prodhimet e vendit si karburantet, pijet alkoolike, rakia, vera, birra dhe duhani.

#### **Menjëherë**

7. Duke qenë se sanksionet ligjore janë frenues të evazionit të mundshëm fiskal DPD të rrisë numrin dhe impaktin e hetimeve dhe kallëzimeve penale ndaj subjekteve importues dhe prodhues të mallrave të akcizës që i shmangen detyrimeve ligjore.

#### **Vazhdimisht**

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit z. Livan Hoxha Përgjegjës Grupi, z. Sali Agaj, dhe z. Saimir Muçmataj, anëtarë. Më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit z. Rejnald Muça

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**